



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2023



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Më datë:27.04.2023

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi,Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi,Nënkryetar i Komunës

Zahir Doda , Drejtoria e Arsimit

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fatmir Qaka, EVSB

Shemsedin Abazi-KLSP

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Menagjimi i Emergjencave -Fatkeqsitë Natyrore
- 4.Informatë për punën e inspektorëve komunal për vitin 2022
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë .

Halim Shehu i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile.

Gjithsejtë kemi pasur 40 raste ku prej tyre 9 janë vjedhje të rënda dhe vjedhje në tentativë,lëndime të rënda dy raste,lëndime të lehta trupore 4 raste,dëmtim prone një rast,mashtrime tri raste,tri dëmtime të kabllave të postës dhe internetit,keqpërdorim i besimit një rast , një rast të ngacmimit seksual, dhunë në famile dy raste , incident të zjarrit një rast, kanosje e personit zyrtarë një rast , falsifikim i parasë një rast , vjedhje e shërbimeve tri raste , zjarrvënje një rast , armëmbajtje pa leje dy raste , sulme dy raste , kanosje pesë raste , ndërhyrje në sistemin kompjuterik një rast , shantazh një rast , mosndërmarrje të masave për siguri në punë një rast .

Përkundër numrit të vogël të zyrtarëve policorë që kemi në dispozicion në qytet gjendja e sigurisë është e qetë.Problematikë e kahmotshme janë vend parkingjet por që për momentin qëndrojnë mirë.

Shqetësim për momentin është vendosja e karrikave dhe tavolinave nëpër trotuare nga kafiteritë e që është në kundërshtim me një vendim të Drejtorisë Shërbimeve Publike që ua ndalon këtë veprim.Për këtë kërkoj bashkëpunim me inspektorët komunal që të veprojnë në pengimin e kësaj dukurie.Mungon bashkëpunimi me qytetarë në mbrojtjen e pyjeve ku gjendja më e rënduar është në pjesën e Parkut Nacional që menagjohet nga niveli qendrorë.Ka mungesë të rojeve të pyjeve dhe kjo pjesë nuk menagjohet si duhet.Shqetësuesë janë dënimet e vogla që po marrin dëmtuesit e pyjeve nga gjykata ngase të njetit po mirren prap me këtë veprimtari.

Kryetari:nga raportet që kam marrë nga të gjitha sektorët por edhe nga raporti i komandantit të policisë na gëzon fakti se gjendja e sigurisë në përgjithsi në këtë periudhë kohore ka qenë e mirë.Shpresoj se edhe në të ardhmën me një bashkëpunim të ndërsjellë do ta kemi situatën e sigurisë nën kontrollë.

Menduh Krasniqi:sa për informim është mbajtur një takim në zyrën e Kryetarit në lidhje me pengesat që pronarët e kafiterive i bëjnë në trotuare duke vendosur karrike e tavolina.Me ua thënë të drejtën kemi bërë tolerancë në këtë drejtim pasi që ishte muaji i ramazanit dhe gjithashtu

nuk kemi pasur ndonjë ankesë nga qytetarët. Ne si inspektorat kemi edhe planin operativ në kuadër të planit vjetor dhe tash e tutje nuk do të ketë tolerancë.

Halim Shehu: thirrjet telefonike të qytetarëve në lidhje me këtë dukuri po adresohen tek policia dhe është mirë që të bashkërendohemi në pengimin e kësaj dukurie.

Fatmir Qaka: në çdo takim nxjerrim edhe rekomandime e ndër rekomandimet ka qenë edhe pengimi i dukurisë që pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve në trotuare. Këto rekomandime bëhen publike në faqën e komunës dhe nuk është mirë të anashkalohen.

3. Menagjimi i Emergjencave -Fatkeqsitë Natyrore

-Në këtë pikë të rendit të ditës Kryetari fjalën ia dha zyrtarit të Emergjencave.

Bujar Bajra: gjat kësaj periudhe kohore kemi pasur disa raste të intervenimit me njësitin e zjarrfikësve e që vlenë të theksohet dëmtimi i një shtëpie në rrugën „Sali Bajra” që dëmet janë të konsiderueshme . Kemi pasur edhe raste të tjera të rrëshqitjes së dheut dhe dëmtime të rrugëve por që është intervenuar nga kompania e kontraktuar ku dhe është riparuar dëmi. Kohëve të fundit kemi pasur një rast të rrëshqitjes së dheut me qrast është rrezikuar një familje. Ne si komunë dhe policia kemi dalë në vend ngjarje dhe kemi evakuar anëtarët e kësaj familje . Edhe nga erërat e fuqishme nëpër disa lokalitete kemi pasur dëme të konsiderueshme .Në fshatin Trimor ka ndodhur një rrëshqitje e dheut me qrast janë rrezikuar tri lagje të këtij lokaliteti. Nga një komision i formuar është bërë vlersimi i gjendjes dhe shumë shpejtë pritet të intervenohet në sanimin e kësaj gjendje.

Me një vendim të Kryetarit është themeluar një grup punues për hartimin e një plani për vlerësim të rrezikut dhe fatkeqsitë tjera në komunën tonë, ku mendohet që në bashkëpunim edhe me nivelin qendrorë të organizohet një punëtori për hartimin e këtij plani që do të jet i mirëseardhur për komunën tonë.

Halim Shehu: më intereson të dijë që në të gjitha këto raste a është faktori njeri që ka qenë faktorë që ka ndiku në shkaktimin e këtyre rasteve.

Bujar Bajra: në shumicën e rasteve është faktori njeri që ka ndikuar në shkaktimin e rrëshqitjeve e dheut por edhe të zjarrvënjes.

Naim Hysa: plani për menagjim të emergjencave dhe fatkeqsive natyrore është i domosdoshëm që ta ket komuna dhe është mirë që të angazhohemi të gjithë akterët për përpilim të një plani të mirëfillt.

Propozoj që në të gjitha fshatrat që kanë rrejtin e ujësjellësit të ndërtohen hidrante që do ta lehtësonte punën për intervenime nëse do të ndodhte ndonjë rast zjarri.

Gjithashtu mendoj se të gjitha objektet si private e institucionale të paisen me aparate për fikjen e zjarrit .

Një sistem alarmimi është i nevojshëm për komunën tonë që në rast të ndonjë fatkeqsie të alarmohen qytetarët.

Vërshimet janë një dukuri që na përcjellë për çdo sezonë dhe është mirë që të punohet në parandalim të kësaj dukurie.

Bujar Bajra; aparatet për fikjen e zjarrit në institucione sidomos publike janë të obligueshme dhe kemi kërkuar nga Drejtoria e Administratës që të përpiloj një listë për objektet komunale dhe të bëjnë një kërkesë për furnizim me këto aparate.

Halim Shehu: për këto aparate duhet të jetë një person apo kompani e licencuar që bënë mbushjen e këtyre aparateve dhe më intereson të dijë se a ka komuna e Kaçanikut një person apo kompani që mirret me këtë punë.

Bujar Bajra: në komunën tonë nuk kemi por që është një person në komunën e Ferizajit dhe është i licencuar për furnizim dhe mirëmbajtje .Deshta me u ndërlidhë edhe me dukurinë e vërshimeve , që për fat të mirë e ka kursyer komunën tonë por që kjo është edhe e mira e preventivës që është ndërmarrë më herët në futjen e përrenjëve në shtrat.Më e rrezikuara është pjesa mbi shkollën e mesme profesionale ku lumi lepenç nuk është në shtrat dhe disa lagje të Kaçanikut të Vjetër ku për rreth tyre kalon lumi Nerodime.

Fatmir Qaka: çfar kapacitete kanë njësitë e emergjencës duke përfshirë edhe Bifurkacionin për ndonjë intervenim të mundshëm?

Bujar Bajra :kapacitetet janë të mangëta si tek njësi i zjarrëfikësve e po ashtu edhe tek kompanitë që në shumë raste fjala është për Bifurkacionin.

Kryetari:Bifurkacioni më herët ka qenë nën nivelin regional ndërsa tash kan kaluar nën nivel qendrorë.Kjo kompani operon në komunën tonë por që i përgjigjet nivelit qendrorë.Kapacitetet e kësaj kompanie janë të mangëta si për paisje e poashtu edhe me staf të punëtorëve.

4.Informatë për punën e inspektorëve komunal për vitin 2022

Menduh Krasniqi:sektori i inspektoratit vepron në kuadër të zyrës së Kryetarit dhe është në këtë përbërje:Inspektori i tregut , i shërbimeve publike , i ndërtimtarisë , i mbrojtjes së mjedisit , i pylltarisë dhe i komunikacionit.Në kuadër të inspektoratit deri në vitin e kaluar ka qenë edhe inspektori sanitar por që tash ka kaluar nën kompetencat e nivelit qendrorë.Duke u bazuar në raportin e vitit 2022 ne kemi kaluar sfida të natyrave të ndryshme si: zënja e hapsirave publike,trotuaret e bllokuara nga bizneset , nga shitësit ambulant që operojnë pa leje komunale , ndotës të ndryshëm të ambientit , zhurma e krijuar nga kafiteritë , operatorë auto-taxi pa leje komunale , mosrespektim i orarit të punës nga subjektet afariste , mosrespektim i orarit të punës nga barnatoret farmaceutike , prerja ilegale e pyjeve dhe transportimi ilegal i drunjëve , ndërtimi i objekteve pa leje komunale , ndërhyrjet e ndryshme në infrastrukturë rrugore dhe shumë sfida të tjera .

Në kuadër të këtij sektori ne kemi edhe planin e punës dhe për realizimin e këtij plani të punës ne kemi inspektuar edhe jasht orarit të punës .Gjat inspektimeve vlenë të theksohet se kemi pasur edhe zyrtarë policorë të cilët kanë asistuar aty ku është parë e nevojshme.

Raportin e punës për vitin 2022 do ua përcjelli në formën elektronike.

Kryetari: është mirë që raportet kur kërkohen paraprakisht të përcillen tek pjesëmarrësit me qëllim që të jenë të njoftuar dhe të parashtrojnë ndonjë pyetje.

Halim Shehu: shqetësim i kahmotshëm është ekspozimi i mallrave nga bizneset në trotuare sidomos në rrugët „Qamil Ilazi” , „Sali Bajra” dhe Vëllezërit Çaka”, ku shpesh po hasim edhe me debate me pronarët e këtyre bizneseve.

Gjithashtu shqetësuese është edhe deponitë e mbeturinave inerte skaj rrugëve , parkingu tek stacioni i autobusëve që çdo ditë punëtorët e këtij stacioni kërkojnë të ndërmarrim masa ndaj atyre që parkojnë automjetet në këtë hapsirë.

Menduh Krasniqi: Ne si inspektorat mundë të mbajmë një takim të përbashkët me stacionin e policisë dhe të bëjmë një plan inspektimi për të ndryshuar gjendjen sa i përket ekspozimit të mallrave në trotuare , ndërsa sa i përket mbeturinave inerte ne si komunë nuk kemi hapsirë për grumbullimin e këtyre mbeturinave por që duhet të gjindet një mundësi ngase ka kërkesa të ndryshme të qytetarëve për hudhjen e këtyre mbeturinave.

5.Të ndryshme

Elmihane Malsiu: një shqetësim që dua të ngris është tek forma e ndëshkimit të fëmijëve që vonohen për në shkollë. Nuk është mirë që këtyre fëmijëve të ju ndalohet hyrja në objektin shkollor për shkak të vonesës por të gjindet një formë tjetër ndëshkuese duke i angazhuar me ndonjë aktivitet përmbrnda objektit shkollor përmes stafit pedagogjik të shkollës . Këto aktivitete të vlejné edhe për ata fëmijë që largohen nga ora e mësimit.

Kryetari: shkollat i kanë udhëzimet administrative por dhe rregulloret e mbrenshme që përcaktojnë masat , të cilat rregullore i kan përpiluar me këshillin e prindërve. Rreth kësaj qështje fjalën ia kisha dhënë Drejtorit të Arsimit.

Zahir Doda: këto vonesa të fëmijëve në shkollë janë bërë sidomos në muajin e ramazanit. Ne si drejtori kemi arritë një objektivë për punësim të psikologëve dhe petagogëve nëpër shkolla. Shkollat i kanë rregulloret e mbrendshme dhe duhet të ju përmbahen këtyre rregulloreve . Për ata nxënës që vonohen për në shkollë dera është e mbyllur dhe lajmrohen prindërit e tyre . Për ata nxënës që largohen nga ora e mësimit shkollat përmes psikologëve dhe pedagogëve zhvillojnë aktivitete mbrenda objektit shkollor. Ndëshkime për vonesa ka edhe për personelin arsimor. Për ndryshim të rregulloreve janë organet e shkollave që mundë të vendosin në bashkëpunim me Këshillin e Prindërve.


REKOMANDIMET

1. Të ndërmerren masa ndaj pronarëve të bizneseve që ekspozojnë mallrat në trotuare.
2. Të bëhet një plan i mirfilltë për emergjenca dh për fatkeqsi të natyrore.
3. Të paisen objektet institucionale me aparate për fikjen e zjarrit si dhe të vendosen shenjat orientuese nëpër këto objekte.
4. Të vendosen hidrante në të gjitha lokalitetet që janë në sistemin e ujësjellësit

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

Be

z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka

